REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 486/26 Dt. 21.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Metodologjisë së Planit të Integritetit të miratuar me vendim nr. 1459/26, të datës 19.08.2026, të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOORDINATORIT PËR PLANIN E INTEGRITETIT PËR KOMUNËN E PRIZRENIT PËR PERIUDHËN 2027-2029

1. Edona Hashani- zyrtare ligjore në Komunën e Prizrenit, emërohet koordinatore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit për Integritet për Komunën e Prizrenit për periudhën 2027-2029.

2. Detyrat kryesore të koordinatores janë:
   2.1. Organizon dhe koordinon punën e Grupit Punues,
   2.2. Siguron komunikim ndërmjet njësive organizative gjatë procesit të identifikimit të rreziqeve,
   2.3. Mbledh dhe sistematizon informacionet dhe dokumentacionin relevant,
   2.4. Mbikëqyr procesin e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve të integritetit,
   2.5. Përgatit draftin e Planit të Integritetit në bashkëpunim me Grupin Punues,
   2.6. Koordinon procesin e konsultimit të draftit të planit,
   2.7. Mbështet procesin e monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit.

3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

4. Obligohet zyrtarja e lartcekur dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurës,
- Organeve tjera kompetente,
- Arkivës së Kryetarit.